



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:013534

Datë: 24.05.2018

Numri i dokumentit: 00044258

P.nr.602/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit V. P. nga fsh. D. K Malishevë, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publikë nga neni 378/9-6 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore –DP ne Gjakovë, PP.nr.1521/16 të datës 03.04.2017, në shqyrtimin gjyqësor fillestar, të mbajtur më datë **11.05.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj përf. ligjor te dëmtuarit prindi B. M., të akuzuarit V. P. dhe mbrojtësit të tij A. K., av. në Malishevë, me **dt. 14.05.2018**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **V. P.**, nga fsh. D. K Malishevë, data e lindjes ..., ku edhe tani jeton, i biri i H. dhe i nënës S. e gjinisë K., ka te kryer shkollën e mesme, student, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i 3 fëmijëve, me ID

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

- me datën **01.10.2017**, rreth orës **19.00 min.**, në Malishevë duke drejtuar automjetin e markës “...” me tar. regj...., ngjyrë hiri metalike, nuk e mban shiritin e tij të drejtimit të lëvizjes e vepron në kundërshtim me nenin 48par4/1të Ligjit Nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve e pasurinë, në atë mënyrë që me të arritur me automjet në rrugën “...”, përball mobilierisë “...”, jo i sigurte nga shiriti i tij i drejtimit të lëvizjes kalon në shiritin për qarkullim të automjeteve në kahje të kundërt, e gjatë kësaj me pjesën e parë të djathtë ballore e godet motoçikletën e cila në atë moment ishte duke qarkulluar në këtë shirit e nga goditja motoçikletën e bartë (shtynë) nga pas diku 13 metra dhe e përplasë në rrugë, e drejtuesit të motoçikletës të dëmtuarit E. F. M. i shkakton lëndime të rënda trupore sipas ekspertizës mjeko-ligjore të Dr. M. G., ndërsa pasagjeri i tij të dëmtuarit E. B. M. nga Malisheva, i shkakton lëndime të rënda trupore nga të cilat vdesë në QKUK në Prishtinë me dt. 03.11.2017.

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378/9-6 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në baze të nenit 4,7,17, 41,45,73,74,75,83, 378/9-6 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarin:

E G J Y K O N

Dënim burgu në kohëzgjatje prej **15(pesëmbëdhjetë) muajve**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt. 01.10.2016 e deri me dt. 28.11.2016.

Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale- ekspertizës së komunikacionit dhe mjeko ligjore të paguaj shumën prej **60.88 €** dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30.00 euro**, në afatin prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria e Themelore –DP në Gjakovë, ka ngritë Aktakuzën P.nr.1521/16 të dt.03.04.2017, ndaj të akuzuarit V. P. nga fsh. D. K Malishevë, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 / 9- 6 të KPRK-ës.

Me dt. 18.08.2017, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas nenit 12 par.4 të ligjit mbi Gjykatat lidhur me nenin 4par.5 të Rregullores për Organizimin e brendshëm të Gjykatave është aprovuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit L. P.- gjyqtar i në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë nga lënda dhe lënda iu nda gjyqtarit në punë sipas radhës të përcaktuar në regjistër për ndarjen e lëndëve në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 11.05.2018, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë, Prokurori Ismet Tofaj, lexoi aktakuzën dhe deklaroi se mbetet në tërësi pran aktakuzës.

Përf. ligjor i të dëmtuarit E. M. ,prindi B. M., deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe se nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi me qene se me të akuzuarin sipas traditave dhe zakoneve jemi pajtuar për çka edhe në gjykatë është prezantuar marrëveshja për pajtim e lidhur me dt. 28.10.2016, gjithashtu me dt. 28.03.2018 GJTH në Gjakovë –Dega në Malishevë në seancën përgatitore C.nr.215/16 është arritur pajtimi gjyqësor në mes të Kompanisë së sigurimeve dhe perf. ligjor prindit të ndjerit E. M. , B. M. .

I akuzuari V. P. ,gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë, thekson se pas konsultimit me mbrojtësin av. A. K. e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion

Mbrojtësi i të akuzuarit av. A. K., deklaroi se pas konsultimit me të mbrojturin tim lidhur me aktakuzën e PTH në Gjakovë PP.nr. 1521/16, ku i mbrojturi im akuzohet për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/9-6 të KPRK-ës. I mbrojturi im e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa presion dhe pa shtytje duke i kuptuar pasojat e pranimi të fajësisë, i njëjti edhe në polici gjate marrjes në pyetje gjithashtu edhe në prokurori ka pranuar se ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet. I mbrojturi im edhe në deklaratën në prokurori ka sqaruar rastin se rasti ka ndodh si pasojë

e errësirës dhe pasi ka dhënë sinjalizimin për tejkalim papritmas ka hasur ne motoçikletën e cila ishte pa drita dhe nuk ka pasur asnjë mundësi që ti shmanget këtij aksidenti edhe pse e ka bere te pamundurën për ta evituar këtë . I akuzuari me te dëmtuarit ka arritur marrëveshje për pajtimin dhe janë pajtuar me familjaret për faktin se rasti ka ndodh pa dashje ,pa paramendim dhe pa qellim te caktuar .Gjithashtu te dëmtuarit sa i përket kërkesës pasurore juridike janë kompensuar nga kompania e sigurimeve “...” dhe si dëshmi gjykatës i ofrojmë pajtimin mes familjareve dhe marrëveshjen gjyqësore për kompensim demi mes te dëmtuarve dhe kompanisë se sigurimit .Me këtë rast aktakuza e PTH ne Gjakovë është e bazuar mirëpo për te akuzuarin është rasti i pare qe ka ndodhur dhe qe ka ra ndesh me ligjin, i akuzuari është familjar ,mbajtës i familjes ,duke i marr te gjitha këto rrethana parasysh si dhe pranimin e fajësisë gjykatës i propozoi qe me rastin e shqiptimit te dënimit te këtë parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e pranimit te fajësisë ashtu siç parashihet ne kodin penale te R. Kosovës.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari L. P. : - **me datën 01.10.2017 ,rreth orës 19.00 min.**, në Malishevë duke drejtuar automjetin e markës “...” me tar. regj...., ngjyrë hiri metalike , nuk e mban shiritin e tij të drejtimit të lëvizjes e vepron në kundërshtim me nenin 48par4/1të Ligjit Nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që rrezikon trafikun publik , jetën e njerëzve e pasurinë , në atë mënyrë që me të arritur me automjet në rrugën “...”, përball mobilierisë “...”, jo i sigurte nga shiriti i tij i drejtimit të lëvizjes kalon në shiritin për qarkullim të automjeteve në kahje të kundërt , e gjatë kësaj me pjesën e parë të djathtë ballore e godet motoçikletën e cila në atë moment ishte duke qarkulluar në këtë shirit e nga goditja motoçikletën e bartë (shtynë) nga pas diku 13 metra dhe e përplasë në rrugë , e drejtuesit të motoçikletës të dëmtuarit E. F. M. i shkakton lëndime të rënda trupore sipas ekspertizës mjeko-ligjore të Dr. M. G., ndërsa pasagjeri i tij të dëmtuarit E. B. M.nga Malisheva , i shkakton lëndime të rënda trupore nga të cilat vdesë në QKUK në Prishtinë me dt. 03.11.2017.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza si: Kallëzimi penal me nr. të rastit DR.-3004-0396-16 i dt. 01.10.2016, Raporti i vend shikimit të aksidentit me skicë e foto dokumentacion të dt. 01.10.2016 ,raportet mjekësore me nr. të protokollit i dt. 01.10.2016 i lëshuar nga QKUK në Prishtinë , certifikate e vdekjes dt.31.10.2016 nga MD-Instituti i mjekësisë ligjore dhe certifikata e vdekjes me ref. e dt. 03.11.2016 ,Akt ekspertiza mjeko – ligjore e Dr. M. G.e dt. 31.03.2017, Ekspertiza e aksidentit të komunikacionit e dt. 24.01.2017 , procesverbali mbi pajtimin gjyqësor i me nr. C.nr.215/16 ,Marrëveshjet për pajtim e dt. 28.20.2016 në mes familjes M. dhe P. dhe në mes të familjeve M. dhe P., foto dokumentacioni dhe ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese

gjykata e konsideroi faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale te rrezikimit te trafikut publik nga neni 378 par.9-6 të KPRK-ës, përkatësisht shkaktimi i aksidentit me fatalitet ,ku i mituri E. M. ka vdekur kurse i mituri E. M. ka pësuar lëndime të rënda trupore ,ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari , sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykatë ,shprehjen e keqardhjes familjareve te dëmtuarve , pendimin e tij për veprimin e bërë nga pakujdesia , arritja e marrëveshjes për pajtim në mes të familjeve të dëmtuarve dhe të akuzuarit, deklarimi i përf. ligjor të ndjerit E. M. –prindit B. M. se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi me që të njëjtën e ka realizuar sipas marrëveshje për pajtim me dt. 28.03.2018, faktin se i akuzuari me pare nuk ka qene i dënuar, si dhe gjendjen e dobet ekonomike .Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personaliteti i tij ,që te Gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm , korrekt, i urtë dhe i vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata e vlerësoi pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar si dhe gjendjen emocionale të tij nga momenti i shkaktimit të aksidentit , të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 75 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarin e gjykon me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) muajve , e në te cilën dënim duhet ti llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt. 01.10.2016 gjerë me dt. 28.11.2016, me bindje se edhe me këtë dënim do te arrihet qëllimi i dënimit dhe se ky dënim i shqiptuar sipas bindjes se gjykatës është ne proporcion me veprën penale te kryer dhe me rrethanat personale te cilat i posedon i akuzuari , i paraparë nga neni 41 te KPRK-ës.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua në nenin 463 par.2 te KPPK-së.

Vendimi që të akuzuarit V. P. ,ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi u murr në bazë të nenit 83 par.1 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragraf 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.602/17 më dt.14.05. 2016.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij në dorëzim , Gjykatës se Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.